

Energji Ashta Sh.p.k

NIPT K82417005V

Pasqyrat Financiare
Per periudhen e mbyllur ne 31 Dhjetor 2008


Energji Ashta Sh.p.k

Bilanci Kontabel

Me 31 Dhjetor 2008

	<i>Shenime</i>	<u>2008</u> <i>(ne Lek)</i>
Aktivitet		
Aktive Afatshkurtra:		130,008,054
Paraja dhe Ekuivalente te saj	4	130,008,054
Totali i Aktiveve		<u>130,008,054</u>
Pasivet		
Detyrime Afatshkurtra:		3,250,255
Shpenzime per periudha te ardhshme	8	1,052,300
Detyrimi i Tatimit mbi Fitimin	6,11	312,233
Hua	5	1,885,722
Kapitali:		
Kapitali themeltar	7	125,000,000
Fitimi i ushtrimit		1,757,799
Totali i kapitalit		<u>126,757,799</u>
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit		<u>130,008,054</u>

Ky bilanc eshte krijuar per tu lexuar bashke me shenimet e meposhtme te faqeve 1 dhe 11 te cilat jane pjese perberese te kesaj pasqyre



Dietmar Reiner
Administrator

KPMG Albania

Pergatitur nga

KPMG Albania Sh.p.k.

KPMG Albania Sh.p.k.

Energji Ashta Sh.p.k

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve


Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2008

	<i>Shenime</i>	<u>2008</u> <i>(in Lek)</i>
Shpenzime per sherbime	8	1,052,300
Rezultate te aktiviteteve operacionale		(1,052,300)
Te ardhura financiare		
Te ardhura nga diferencat e kembimeve	9	3,114,941
Te ardhura nga interesi	9	18,054
Shpenzime financiare		
Shpenzime nga diferencat e kembimeve	10	10,662
Kosto Financiare Neto		3,122,332
Fitimi para tatimit		2,070,032
Shpenzim i tatimit mbi fitimin	11	(312,233)
Fitimi per periudhen		1,757,799

Kjo pasqyre te ardhurash eshte krijuar per tu lexuar bashke me shenimet e meposhtme te faqeve 1 dhe 11 te cilat jane pjese perberese te kesaj pasqyre.



Dietmar Rejner
Administrator


Pergatitur nga
KPMG Albania Sh.p.k.

KPMG Albania Sh.p.k.

Energji Ashta Sh.p.k

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital


Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(ne Lek)

	<i>Kapitali themeltar</i>	<i>Fitime te pashperndara</i>	<i>Total</i>
Emetimi i Kapitali Themeltar	125,000,000		125,000,000
Fitimi i periudhes	-	1,757,799	1,757,799
Balanca ne 31 Dhjetor 2008	125,000,000	1,757,799	126,757,799

Kjo pasqyre e ndryshimeve ne kapital eshte krijuar per tu lexuar bashke me shenimet e meposhtme te faqeve 1 dhe 11 te cilat jane pjese perberese te kesaj pasqyre.


Dietmar Reiner
Administrator



Pergatitur nga
KPMG Albania Sh.p.k.


Energji Ashta Sh.p.k**Pasqyra e flukseve monetare**

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2008

	<i>Shenime</i>	<u>2008</u>
		<i>(ne Lek)</i>
Aktivite Shfrytezuese		
Fitimi per periudhen		1,757,799
Sistemimc per:		
Shpenzime te periudhave te ardhshme	8	1,052,300
Te ardhura nga interesat	9	(18,054)
Tatim fitimi	11	312,233
Fitime neto nga konvertimi	9,10	(3,104,278)
Flukse monetare nga aktivitetet shfrytezuese		<u>-</u>
Te ardhura nga interesat	9	18,054
Flukse monetare nga aktivitetet shfrytezuese		<u>18,054</u>
Aktivite Investuese		
Flukse monetare nga aktivitetet investuese		<u>-</u>
Aktivite financiare		
Derdhja e kapitalit	7	125,000,000
Hua	5	1,885,722
Flukse monetare nga aktivitetet financiare		<u>126,885,722</u>
Ndryshimi neto ne para dhe ekuivalente te saj		126,903,776
Para dhe ekuivalente te saj ne fillim te vitit		-
Efektet nga diferencat e kurseve te kembimit ne para	9,10	3,104,278
Para dhe ekuivalente te saj ne fund te vitit		130,008,054

Kjo pasqyre e fluksit te parase eshte krijuar per tu lexuar bashke me shenimet e meposhtme te faqeve 1 dhe 11 te cilat jane pjese perberese te kesaj pasqyre.


 Dietmar Reiner
 Administrator


 Pergatitur nga
 KPMG Albania Sh.p.k.

Energji Ashta Sh.p.k

Keto pasqyra financiare jane autorizuar nga menaxhimi i Energji Ashta Sh.p.k.ne 27 Korrik 2009 dhe firmosur ne emer dhe per llogari te Energji Ashta Sh.p.k nga:



Dietmar Reiner
Administrator

KPMG Albania

Pergatitur nga
KPMG Albania Sh.p.k.

KPMG Albania Sh.p.k.

1. Entiteti raportues

Energji Ashta Sh.p.k. ("Kompania") është themeluar ne 11 Dhjetor 2008 ne Tirane, Shqiperi me objektivin e ekzekutimit dhe zbatimit te Marreveshjes Koncesionare me Qeverine e Shqiperise, ne lidhje me projektimin, financimin, ndertimin, funksionimin e aktivitetet ndihmese per ndertimin dhe venien ne pune te Hidrocentralit te Ashtes si dhe objekte te tjera te lidhura me to. Kompania eshte regjistruar si filial i VERBUND – International GmbH e cila eshte nje kompani rezidente ne Austri. Energji Ashta Sh.p.k. zoterohet 100% nga VERBUND – International GmbH. Energji Ashta Sh.p.k. eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me 11 Dhjetor 2008.

Adresa e regjistruar e menaxhimit dhe vendi kryesor i biznesit eshte:

Bulevardi "Zogu I", VEVE Business Center, Tirane, Shqiperi.

2. Baza e pergatitjes

a) Deklarata e perpuethshmerise

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me ligjin Nr. 9228, date 29.04.2004 "Mbi Kontabilitetin dhe mbajtjen e pasqyrave financiare" dhe Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar.

b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e kosos historike.

c) Funkzionet dhe prezantimet ne monedhe

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne LEK, e cila eshte monedha lokale e kompanise. Monedha funksionale e kompanise eshte Euro pasi pjesa me e madhe e faturave nga aktivitetet operacionale eshte ne Euro.

d) Perdorimi i parashikimeve dhe gjykimeve

Pergjate pergatitjes te pasqyrave financiare sipas SNRF, gjykimi i menaxhimit eshte kerkuar per sa i perket procesit te aplikimit te politikave kontabel si dhe per percaktimin e supozimeve kyce ne lidhje me zhvillimet e ardhshme te cilat mund te kene ndikim te madh ne njohjen dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve, kerkesave per evidentim ne lidhje me detyrime te tjera ne daten e Bilancit Kontabel dhe te prezantimit te pasqyres se te ardhurave dhe shpenzimeve per gjate periudhes nen shqyrtim.

Politikat e meposhtme te kontabilitetit jane aplikuar ne menyre konsistente.

Ne vecanti, informacioni per fusha domethenese te parashikimeve, pasiguri dhe mendim kritik per sa i perket aplikimit te politikave kontabel te cilat kane ndikimin te madh mbi vlerat e njohura ne pasqyrat financiare eshte pershkruar si meposhte:

e) Zhvleresimi

Kompania rishikon llogarine te arketueshme per te matur zhvleresimin ne baze vjetore. Per te percaktuar ne qofte se nje humbje nga zhvleresimi duhet te regjistrohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, kompania gjykon ne qofte se ka te dhena te observueshme te cilat tregojne qe ka nje renie te matshme ne fluksin e parase te parashikuar nga klienti individual ne grupin e llogarise te arketueshme.

3. Politika te Rendesishme Kontabel

(a) Transaksione ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me normen e kembimit te dites kur ka ndodhur transaksioni. Aktivitet monetare dhe detyrimet e shprehura ne monedha te huaja ne daten e raportimit jane matur ne monedhen funksionale duke perdorur normen e kembimit te Bankes Qendrore Europiane ne ditin e Bilancit Kontabel. Diferencat qe linden nga rikembimi jane njohur si e ardhur ose humbje.

(b) Instrumentat Financiare

Instrumentet jo-derivative te kompanise nenkuptojne llogarite te arketueshme tregtare dhe te tjera, para ja dhe ekuivalente te saj, detyrime tregtare dhe te tjera.

Nje instrument financiar njihet si i tille ne qofte se kompania behet pale me provigjionet kontraktuale te instrumentit. Aktivete financiare nuk njihen ne qofte se te drejtat kontraktuale te kompanise mbi fluksin e parase nga aktivete financiare skadojne ose ne qofte se kompania transferon aktivete financiare paleve te tjera pa pasur kontroll ose pa mbartur risqet dhe fitimet e ketij aktivi. Detyrimet financiare nuk njihen ne qofte se detyrimet e kompanise te specifikuar ne kontrate skadojne, jane pezulluar ose jane anuluar.

(c) Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj nenkuptojne balancat e parase dhe llogarite afatshkurtra bankare te cilat kane nje maturim me pak se 90 dite.

d) Llogarite tregtare te arketueshme dhe te tjera

Llogarite tregtare te arketueshme dhe te tjera i perkasin kategorise hua dhe llogari te arketueshme dhe njihen ne perputhje me SNK (IAS) 39, ne kosto duke i zbritur pershtatjen per shuma qe priten te jene te pambledhshme.

e) Llogarite e detyrimeve tregtare dhe te tjera

Llogarite tregtare te pagueshme dhe detyrime te tjera jane matur ne kosto te amortizuar.

f) Letrat me vlere dhe huate

Letrat me vlere, pervec atyre ne lidhje me transaksione qiraje jashte kufijve, jane te kategorizuara si "gati per shitje". Instrumenta financiare te cilat nuk jane borxhe apo llogari te arketueshme, te cilat nuk mbahen deri ne maturim dhe jo te matura me vlere te drejte pergjate shperndarjes se humbjes apo fitimit per kete kategori. Njohja qe behet per bilancin kontabel eshte me te drejte, e cila percaktohet ne base te cmimit te aksioneve. Ne perputhje me SNK (IAS) 39, ndryshimet ne vlere njihen direkt ne kapital deri ne momentin e nxjerrjes jashte perdorimit. Zhvleresimi i humbjeve njihet si fitim ose humbje. Te gjitha blerjet dhe shitjet jane njohur duke perdorur daten e tregtimit. Securities te blera ne lidhje me transaksione qiraje jashte kufijve perbehen nga borxhe dhe llogari te arketueshme (Nota Afat-Mesme) dhe te matura ne kosto te amortizuar duke i zbritur humbjen nga zhvleresimi. Borxhet me interes, duke perfshire dhe ato ne lidhje me transaksione qiraje jashte kufijve, jane te klasifikuara te kategoria borxhe dhe llogari te arketueshme dhe jane matur ne kosto te amortizuar duke i zbritur humbjen nga zhvleresimi. Ne rastin e humbjeve nga zhvleresimi, matja eshte bazuar ne vleren aktuale te ripagimeve te pritshme. Te ardhurat nga interesi jane njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzime sipas metodes te interesit efektiv.

g) Detyrimet financiare

Detyrimet jane te njohura ne momentin e hyrjes dhe te matura ne shumen aktuale minus koston e transaksionit. Primet, zbritjet apo diferenca te tjera ndermjet shumes se marre dhe te ripagimit jane shperndare ne baze te metodes se interesit efektiv dhe te pasqyruara ne rezultatin financiar, te shperndara pergjate periudhes se financimit.

h) Aktivete afatgjata materiale dhe aktivete jomateriale

(i) Njohja dhe matja

Aktivete jomateriale te blera jane njohur sipas SNK (IAS) 16, te njohura me kosto minus amortizimin e llogaritur mbi bazen e metodes lineare dhe shpenzimet e amortizimit te paparashikuara per humbjet nga zhvleresimi, te cilat jane njohur si zhvleresim dhe amortizim.

Kostot e zhvillimit kane kaluar si shpenzim ne momentin e ndodhur si pasoje e faktit qe kriteret e njohjes sipas SNK (IAS) 38 nuk jane plotesuar dhe si pasoje e faktit qe keto shuma kane qene jomateriale.

Tokat, ndertesat dhe pajisjet te perdorura per nje periudhe me te gjate se nje vit jane te njohura ne momentin e blerjes apo prodhimit minus amortizimin e parashikuar me metoden lineare dhe humbjeve nga zhvleresimi.

Si shtese e kostove direkte, kostot perkatese indirekte per materiale dhe pune jane perfshire ne kostot e blerjes apo te aktivitetit te prodhuar vete.

Amortizimi i aktiveve me jete perdorimi te kufizuar, dhe te aktiveve te zhvleresueshme, bazohet ne vleren e pritshme te perdorimit te aktiveve. Brenda grupit perdoren afatet e meposhtme si jete perdorimi:

PERIUDHA E PERDORIMIT	VITE
AKTIVE JOMATERIALE ME JETE PERDORIMI TE KUFIZUAR	10 – 30
NDERTESA	
REZIDENCIALE, ZYRA, DHE NDERTIME TE TJERA	20-50
HIDROCENTRALE	75
NDERTESA TEKNIKE DHE MAKINERI	10 – 50
PAJISJE ZYRE DHE NDERTESASH	4 – 10

(ii) *Aktivet e marra dhe te dhena me qira*

Ne rastin e aktiveve te dhena me qira, te gjitha risqet dhe te ardhurat nga aktive te tilla I kalojne qiranarresit (qira financiare), qiradhenesi sipas SNK (IAS) 17, nuk do te njohe aktivin e dhene me qira por do te njohe vleren aktuale te te gjitha kesteve nga qiraja te cilat do te marre pasi jane zbritur parapagimet e marra. Diferenca ndermjet vleres aktuale te kesteve te ardhshme financiare dhe shumes se kesteve te qirase financiare te pa skontuara perben te ardhura te shtyra nga interesat dhe do te realizohen gjate termave te kontrates ne menyre proporcionale me shumen e mbetur te arketueshme.

Ne menyre te ngjashme, ne rastin e aktive te qendrueshme te trupezuara te marra me qira ku Kompania mban gjithe risqet dhe perfitimet, aktivi kategorizohet si aktiv jo I qendrueshem me vleren e tashme te pagesave minimale per qerane dhe vlera e tashme e obligimit paraqitet si detyrim.

(iii) *Marreveshjet Koncesionare te sherbimit KIRFN (IFRIC) 12*

Koncesioni duhet te kontabilizohet si Marreveshje Koncesionare Sherbimi sipas objektit te KIRFN (IFRIC) 12. Per shkak se marreveshja konsiston ne nje periudhe 15 vjecare tarifash fikse dhe ne nje peridhe 20 vjecare tarifash ne varesi te shitjeve me shumice, kontabiliteti sipas KIRFN (IFRIC) 12 e ndan marreveshjen ne aktiv financiar dhe jomaterial (modeli i perzier). Si pjese e marreveshjes se marrjes persiper “off-take” me kompanine Shqiptare, KESH Sh.a i garanton Enerji Ashta Sh.p.k. te drejten e pakufizuar per ti faturuar tarifa fikse per periudhen fillestare prej 15 vjetesh te marreveshjes. Kjo pjese konsiderohet si aktiv financiar. Ne baze te politikave kontabel te Verbund-it, aktivi financiar klasifikohet si nje lloari e arketueshme. Vlera e drejte e mbetur e koncesionit njihet si nje aktiv jomaterial dhe amorizohet pergjate periudhes se koncesionit.

(i) **Zhvleresimi i aktiveve jo financiare**

Te gjitha aktivet jo-financiare object i SNK (IAS) 36 jane testuar ne lidhje me vleren e tyre te mbartur per te pare nese ka ndonje tregues per zhvleresim (testi i zhvleresimit). Ne rastin e “Emrit te mire”, aktiveve jomateriale me jete te pakufizuaar perdorimi dhe aktiveve qe nuk jane akoma ne dispozicion per shitje, testi i zhvleresimit kryhet nje here ne vit edhe nese nuk ka tregues per zhvleresim. Zhvleresimi ekziston kur vlera e mbartur eshte me e madhe se sa vlera e rikuperueshme e aktivitetit Vlera e rikuperueshme eshte vlera me e larte midis vleres ne perdorim dhe vleres se drejte duke i zbritur dhe kostot per shitjen e aktivitetit. Vlera ne perodorim percaktohet duke perdorur nje vlere aktuale te orientuar ne perputhje me metoden e flukseve te parase te skontuara. Ketu, flukset e parase rrjedhin ne baze te planeve financiare te menaxhimit te Kompanise. Norma e kapitalizimit eshte norma para tatimit qe reflekton vleresimet aktuale te tregut mbi vleren e parase ne kohe dhe risqet specifike te shoqeruara me aktivin. Humbjet nga zhvleresimet duhet te njihen deri ne masen qe vlera e mbartur tejkalon vleren e rikuperueshme. Nese ne periudhat e metejshme, nuk ekzistojne me tregues per zhvleresim, humbjet nga zhvleresimi rimerren. Kjo nuk aplikohet per emrin e mire.

(j) **Provigjionet**

Provigjionet krijohen nese kompania ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv me nje pale te trete ne lidhje me nje ngjarje te shkuar dhe nese eshte e ngjare qe ky detyrim do te rezultojte ne nxjerrje jashte te fondeve. Provigjione te tilla njihen ne ate mase qe mund te percaktohet ne kohen e pergatitjes se pasqyrave financiare, mbi bazen e vleresimeve me te mira. Nese nje vlere e tille nuk mund te matet arsyeshem, nuk do te krijohet asnje provigjion. Nese vlera aktuale e provigjionit, e percaktuar mbi bazen e nje norme skontimi, ndryshon shume nga vlera nominale, provigjioni do te njihet ne vleren e aktualizuar te detyrimit.

Shpenzimet ne lidhje me interesat e grumbulluara per provigjionet afat gjata njihen si shpenzime per interesa.

(k) Tatim fitimi

Shpenzimi i tatim fitimit i njohur per vitin tatimor perfshin tatim fitimin e llogaritur per kompanine bazuar ne fitimin e tatueshem dhe normen tatimore te aplikuar si gjithashtu edhe ndryshimet ne detyrimet dhe aktivet e tatimit te shtyre.

Aktivitet dhe detyrimet e tatimit te shtyre percaktohen duke perdorur metoden e detyrimit te bilancit sipas SNK (IAS) 12 per te gjitha diferencat e perkohshme ndermjet vlerave kontable dhe bazave tatimore te aktiveve dhe detyrimeve te njohura ne pasqyrat financiare sipas SNRF. Gjithashtu, avantazhi tatimor qe ekziston per mbartjen e humbjeve tatimore qe jane te mundshme per t'u realizuar eshte perfshire ne llogaritjet. Perjashtime nga ky rregull bejne diferencat e perkohshme ne lidhje me interesat pjesmarres qe nuk rezultojne nga amortizimet efektive-tatimore te investimeve.

(l) Njohja e te ardhurave

Te ardhurat nga sherbimet njihen kur sherbimet jane kryer.

(m) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesat mbi fondet e investuara ne depozita bankare dhe fitimet nga kurset e kembimit. Te ardhurat nga interesat njihen sipas parimit te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet per interesa mbi huate, humbjet nga kurset e kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura sipas vleres se drejte, nepermjet te ardhurave dhe shpenzimeve, dhe humbjeve nga zhvleresimet e aktiveve financiare. SNK (IAS) 23 "Kostot e humarrjes" i rishikuar, konkludon ne moslejimin e opsionit te njohjes se kostove te humarrjes qe mund t'i shperndahen direkt blerjes apo ndertimit, prodhimit te nje aktiviteti te kualifikuar, si shpenzime. Ne te ardhmen, keto kosto humarrje qe duhet te kapitalizohen si pjese e koston e aktivitetit te kualifikuar.

4. Paraja dhe Ekuivalente te saj

Paraja dhe Ekuivalente te saj jane si me poshte :

	<i>31 Dhjetor 2008</i> <i>(ne Lek)</i>
<i>Para ne Banke</i>	
Raiffeisen Bank (EUR)	130,008,054
Paraja dhe ekuivalente te saj per qellimet e Pasqyres se Fluksit te Parase	130,008,054

5. Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme perbehen si me poshte:

	<i>31 Dhjetor 2008</i> <i>(ne Lek)</i>
Hua	1,885,722
	1,885,722

6. Llogari te pagueshme te tjera

Llogarite te pagueshme te tjera perbehen si me poshte:

	<i>31 Dhjetor 2008</i> <i>(ne Lek)</i>
Tatimi mbi fitimin	312,233

7. Kapitali themeltar

Me 31 Dhjetor 2008 kapitali themeltar i autorizuar, dhe i paguar i Kompanise eshte 125,000,000 Lek. Kompania nuk i ka vendosur te drejta, preferenca apo kufizime kapitalit themeltar me 31 Dhjetor 2008.

8. Sherbime

Balanca perbehet si me poshte:

	<i>2008</i> <i>(in Lek)</i>
Konsulenca ligjore	619,000
Kosto te informacioneve teknologjike	247,600
Sherbime kontabiliteti	185,700
Total	1,052,300

9. Te ardhurat financiare

Balanca perbehet si me poshte:

	<i>2008</i> <i>(in Lek)</i>
Te ardhura nga interesat	18,054
Te ardhura nga diferencat e kurseve te kembimit	3,114,941
Total	3,132,995

10. Shpenzime te tjera

Balanca perbehet si me poshte:

	<i>2008</i> <i>(ne Lek)</i>
Humbje nga diferencat e kurseve te kembimit	10,662
Total	10,662

11. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

	<i>2008</i> <i>(ne Lek)</i>
Fitimi perpara taksave	2,070,033
Shpenzime te pazbritshme	1,052,300
Fitimi i Tatueshem	3,122,333
Detyrimi per tatim fitimin	312,233
Tatim fitimi i parapaguar	-
Tatim fitimi i pagueshem ne fund te 2008	312,233

11. Ngjarje pas dates se bilancit

Ne periudhen fiskale 2009 nje partner strategjik do te gjendet per te asistuar ne projektin e Ashtes. Ky partner strategjik do te mbaje rreth 50 % te interesave te projektit.